



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:140984

Datë: 18.07.2024

Numri i dokumentit: 05951457

**K.DH.SH.II.nr.727/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “UNI” ShPK me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti, KF.nr.689/23 të datës 05.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.07.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti, KF.nr.689/23 të datës 05.02.2024 dhe çështja gjykohet si vijon:

**REFUZOHET** si a pabazuar kërkesëpadia e paditësit “UNI” ShPK me seli në Prishtinë, dhe **MBETET NË FUQI** vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës nr.01.3.2.2/6117 i datës 24.05.2021.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A R S Y E T I M**

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti, KF.nr.689/23 të datës 05.02.2024, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit “UNI” sh.p.k, me seli në Prishtinë, si e bazuar. II. Anulohet aktvendimi me nr.01.3.2.2/6117 i datës 24.05.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë, III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “UNI” Sh.P.K, me seli në Prishtinë, t’ia kthejë mjetet e paguar në emër të gjobës shumë prej 250.00 €, blerjes së mallit të konfiskuar shumë prej 630.00 €, si dhe në emër të detyrimeve doganore shumë prej 187.74 €, gjithsejtë 1,067.74 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data 05.04.2021, e deri në pagesën

definitive, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedural.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka e paditura Dogana e Kosovës, ka ushtruar ankesë për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës material, me propozim që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar me ligj, të prishet aktgjykimi KF.nr.689/2022 i datës 05.02.2024 si i pa bazuar me ligj, të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pabazuar me ligj.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, e vlerësuan ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar, si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 i LPK-së, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, e vlerësuan ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në vështrim të nenit 49 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me aktvendimin nr. 01.3.2.2/6117 të datës 24.05.2021 e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e subjektit në procedurë “Uni” ShPK - Prishtinë, për rishqyrtimin e aktvendimit nr.03.1.7-403 datë 02.04.2021 të lëshuar nga sektori i Kundërvajtjes Doganore Prishtinë.

Në aktvendimin e kontestuar është theksuar se procedura e kundërvajtjes është iniciuar ndaj subjektit në procedurë, sepse me datë 01.04.2021, në Zyrën doganore Aeroport, është paraqitur për zhdoganim lënda me numër të deklaratës R-4693/01.04.2021, dhe gjate kontrollës doganore nuk i ka paraqitur mallin Fotrolla – çanta për gërshtë në sasi prej 900 pce, në vlerë prej 630.00€, pra Doganës së Kosovës nuk i ka paraqitur mallin, me qëllim të shmangies së taksave doganore në shumë prej 187.75€, me ç ‘rast kishte kryer kundërvajtje doganore nga 276 paragrafi a) të Kodit Doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Fillimisht Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal, me aktgjykimin A.nr.1458/21 të datës 29.03.2022 e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe ka lënë në fuqi vendimin kontestues nr.01.3.2.2/6117 të datës 24.05.2021 të Doganës së Kosovës.

Dhomat e shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, me aktvendimin K.DH.Sh.II.nr.1161/22 të datës 13.07.2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit, duke e prishur Aktgjykimin A.nr.1458/21 të datës 29.03.2023 dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të lartcekur, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor datës 05.02.2024, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës ka marr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar aktvendimin nr.01.3.2.2/6117 të datës 24.05.2021 të Doganë së Kosovës në Prishtinë dhe ka obliguar të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit t'ia kthejë mjetet e paguar në emër të gjobës shumë prej 250.00 €, blerjes së mallit të konfiskuar shumë prej 630.00 €, si dhe në emër të detyrimeve doganore shumë prej 187.74 €, gjithsejtë 1,067.74 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data 05.04.2021, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësimet faktike dhe juridike në këtë konflikt administrativ mbi të cilat ka konstatuar se pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme subjektit në procedurë i ka shqiptuar gjobën administrative në vlerë prej 500.00 €, ngase paditësi në këtë procedurë të kontestit tregtar-administrativ i ka paraqitur gjykatës provën si faturën nr. AA120/2021, packing list, pro faturën nr.787090/21, pagesat bankare ndërkombëtare të datës 27.01.2021 dhe 24.03.2021, me të cilat dokumente vërtetohet fakti se subjekti në procedurë, këtu paditësi ka deklaruar saktë mallin sipas faturës përcjellëse dhe se në mënyrë të saktë është deklaruar edhe sasia dhe vlera e tij, tutje pagesat bankare të lartcekura dhe fatura nr. AA120/2021, kanë përputhshmëri të plotë me njëra tjetrën sa i përket vlerës së mallit lëndor kontestues.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë, sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkalle se pare rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejte dhe i ligjshëm, pasi qe aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktin administrative nenit 43 dhe 44 si dhe ne shkelje te nenit 183 parag 1 dhe 2 te LPK-se, si dhe aktgjykimin e atakuar ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi qe gjykata ankimore ne baze te njëjtave shkresave te lendes ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike ne raport me gjykatën e shkalles e pare, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditëses del të jetë e pa bazuar, me çka në rastin konkret ka kushte qe aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ku edhe u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se, nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, por në mënyrë të njëanshme duke ia falur besimin me tepër deklarimeve të palëve se provave materiale ka ardhur deri të konstatimet e dhëna në arsyetimin e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar. Aktgjykimi i atakuar gjithashtu është marrë edhe me shkelje të dispozitë së nenin 160.5 të LPK-së ‘ *Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale*

*i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor’’. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, përveç dispozitave për vendimmarrje dhe kamat, nuk ka cekur se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Po ashtu gjykata e shkallës së parë fare nuk e ka shqyrtuar pretendimin e të paditurës se paditësi nuk ka deklaruar mallin lëndore, e për të cilin është shqiptuar kundërvajtja doganore e i cili është objekti i këtij konflikti administrative.*

Dhomat e Shkallës së Dytë ne baze të shkresave të lëndës gjejnë se, aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se, gjykata e shkallës së parë edhe pse i ka vlerësuar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në konkludime të gabueshme lidhur me gjendjen faktike, duke bërë interpretim të gabueshëm të fakteve të vërtetuara dhe duke mos i vlerësuar në tërësi faktet vendimtare, ashtu që e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke konstatuar se paditësi ka deklaruar mallin saktë sipas faturës përcjellëse dhe se pagesat bankare të lartcekura dhe fatura nr. AA120/2021, kanë përputhshmëri të plotë me njëra tjetrën sa i përket vlerës së mallit lëndor kontestues. Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate mbi gjendjen e gabuar faktike, gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështet në fakte të gabueshme dhe pa asnjë baze ligjore.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale erdhën në përfundim se gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka nxjerr duke mos e zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën ligjore nga neni 183 të LPK-së, me të cilën përcaktohet se: *Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.*

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi e ka paraqitur mallin në DUD-in kontestues R-4693/01.04.2021, në emërtimin e parë, me përshkrimin “Gërshërë të vogla, gërshërë rrobaqepësi dhe gërshërë të ngjashme dhe gërshërë të vogla për berberë – 2066pc., mbajtëse të gërshërëve 50pc., TI=2116/PCE”, në vlerë prej 11,901.50€. Fatura nr.AA120/21 e datës 23.03.2021, të cilës i referohet gjykata e shkallës së parë, si faturë përmes të cilës paditësi e ka deklaruar mallin lëndor kontestues, është në vlerë prej 12,601.50€, e cila faturë nuk është në harmoni me vlerën e DUD-it kontestues. Sa i përket pagesave bankare të datës 27.01.2021 në vlerë prej 3,600.00€ dhe pagesës bankare të datës 24.03.2021 në vlerë prej 9,000.00€, të njëjta pagesa janë bërë në emër të pro faturës NO787090/21 të datës 26.01.2021 në vlerë prej 11,901.50€. shuma totale e të dy pagesave bankare paraqet vlerën 12,600.00€, e cila vlerë nuk është në harmoni me pro faturën NO0787090/21 për të cilën është bërë pagesa e mallit.

Kolegji i kësaj gjykate nga shkresat e lëndës ka gjetur se paditësi nuk ka paraqitur para të paditurës apo gjykatës, dokumente që do të dëshmonin se malli Fotrolla – çanta për gërshërë në sasi prej

900pce, është pjesë përbërëse e mallit gërshërë dhe se nuk kemi të bëjmë me produkt të veçantë, për arsye se Kolegji i kësaj gjykate konstaton se nga vet përshkrimi i mallit në DUD-in kontestues ku është përcaktuar edhe malli “Mbajtëse për gërshërë 50pc”, ky produkt është paraqitur i ndarë. Po ashtu edhe pagesa për mallin është bërë në vlerë më të madhe se sa ajo e paraqitur në pro faturat e mallit lëndor dhe DUD-in kontestues. Nga ana tjetër, e paditura ne vendimin kontestues ka theksuar se sikur fotrollat apo çantat të ishin pjesë përbërëse e mallit gërshërë, atëherë gërshërët do të ishin të vendosura në fotrollat apo çantat e tyre. Këtë konstatim në vendimin kontestues përfaqësuesi i paditësi e ka arsyetuar me faktin se të njëjtat janë ndarë për çështje të ekonomizimit të transportit. Këto konstatime të lartcekura për kolegjin e kësaj gjykate janë dëshmi për të konstatuar se vërtet malli lëndor fotrolla - çanta për gërshërë nuk është deklaruar nga paditësi. Gjithashtu nëse do te ekzistonte një pretendim i tillë atëherë malli lëndor ne DUD-in kontestues do te duhet te deklarohet ne tersi sipas përshkrimit te malli duke përshkruar edhe Fotrolla – çanta për gërshërë në sasi prej 900pc, gjithmonë duke mbështetur me dokumentacionin përcjellës te mallit, me qellim qe te harmonizohet dokumentacioni i mallit lëndor me gjendjen DUD-in te deklaruar. Kolegji vlerëson se edhe nëse ky mall do te ishte pjese përbërëse e gërshërëve, atëherë do te duhej te deklarohet drejte ne DUD-in kontestues ‘gërshërë me fotrolla – çanta për gërshërë’ e jo si në rastin konkret ku nuk janë deklaruar fare malli lëndor. Kolegji konsideron se ne rastin konkret nuk është deklaruar drejte dhe nuk është mbështet me dokumentacion malli lëndor nga subjekti ne procedure, me ç ‘rast është kryer kundërvajtje doganore e sanksionuar me nenin 276 paragra a) i KDAK-së parasheh që *“Personi juridik apo fizik: a). Në qoftë se, nuk e paraqet mallin, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000)€.”* Kolegji, nuk ka mundur ti marr parasysh pretendimet e padisë, pasi qe sipas konstatimeve te lartecekuar pretendimet e paditësit janë tërësisht të pa qëndrueshëm dhe të pa mbështetur në prova materiale, njashtu janë shumë kontradiktor në vetvete dhe në raport me dokumentacionin e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, sepse paditësi nuk ka qenë të gjendje të provojë përmes ndonjë dëshmie me të cilin do të argumentohet te kundërtën e konstatimeve te dhëna ne arsyetimin vendimit kontestues. Ne këtë drejtim gjykata konsideron se paditësi nuk ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese dhe nuk i ka mbështet me prova pretendimet e tij ne padi. Andaj, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimet e vendimeve kontestuese, për arsye se, dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor nuk harmonizohet ne kuptim te vlerës dhe deklarimit ne tersi te mallit.

Kolegji vlerëson se ne bazë te nenit 88 paragrafi 1 dhe 4 te UA 11/2009 për zbatimin e Kodit Doganor dhe Akcizave shprehimisht parashihet: *“Kur është i nevojshme përcaktimi i vlerës doganore në kuptim të nenit 32 deri në 40 të Kodit, deklarata në vlerën doganore (deklaratën për vlerën), e shoqëron fletëparaqitjen doganore të përpiluar në lidhje me mallin përkatës, Dorëzimi i deklaratës mbi vlerën e cila kërkohet sipas Paragrafit 1 të këtij neni me mundësit e aplikimit të dispozitave ndëshkimore, personi i paraparë në Paragrafin 2 është përgjegjës për; -Saktësinë dhe kompletimin e të dhënave të përmendura në deklaratë, - Autenticitetin e dokumenteve të ofruara për të mbështetur ato të dhëna dhe, Dorëzimi i të gjitha të dhënave shtesë dhe të dokumentacionit të nevojshëm për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave.*

Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj, rrjedhimisht në këtë kuptim gjykata vlerëson se paditësi nuk ka arritur të mbështes me prova pretendimet e tij ne padi ashtu siç

parashihet me dispozitat e nenit 81.F par. 1 të Ligjit nr. 04-L-102, pasi që në bazë të kësaj dispozite “*Tatimpaguesi do të bart detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij/saj*”. Ndërsa neni 7 par.1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*. Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson si të pabazuara edhe pretendimet e paditësit, sepse në bazë të nenit 319.1 të LPK-së, palët ndërgjyqëse kanë për detyrë që vet t’i provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë pretendimet e tyre ndërsa paditësi nuk ka ofruar prova bindëse mbi të cilat do të mbështeste kërkesën e tij. Ndërsa neni 322 i LPK-se, “*Nëse gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, atëherë për ekzistimin e tijt do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës. 322.2 Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, nëse ligji nuk parasheh diç tjetër*”. Nga kjo rezulton se barra e të provuarit në procedurë bie mbi paditësin që në rastin konkret të dëshmojë dokumentacion për deklarimin se sakte mallit lëndor i cili është objekti i këtij konflikti administrative. Bazuar në të sipërcekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë mbi gjendjen faktike gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj është dashtë që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia si e tillë të refuzohet.

Gjykata vendosi për shpenzimet e procedurës në pajtim me nenin 64 të LKA-se nr. 03/L-202, pasi që sipas këtij neni në konflikt administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Bazuar në të lartcekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë mbi gjendjen faktike gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj është dashtë që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia si e tillë të refuzohet.

Nga të cekurat konform Nenit 195.1 pika e) dhe 201 b) të LPK-së u vendos si ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.727/24, me dt. 11.07.2024**

**Kryetari i Kolegjit, gjyqtari**  
**Ramush Bardiqi d.v.**